



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 201/2 Prot.

Tiranë, më 20.01.2025

VENDIM
Nr. 3 datë 20.01.2025

**“PËR
MIRATIMIN E PAGESËS PËR STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE
“MËSUESI NË EDUKIM FIZIK DHE SHËNDETËSOR”, PËR KOHËN E PROGRAMUAR TË
PRAKTIKËS PROFESIONALE PEDAGOGJIKE NË EDUKIM FIZIK, PËR KONTRIBUTIN E
DETYRUESHËM PËR AKSIDENTE NË PUNË DHE SËMUNDJE PROFESIONALE”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë” neni 38, në Statutin e UST-së, në Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimit nr.9, datë 20. 03. 2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar, kreu I, pika 1, germa f, kreu III, pika 12, në shkresën e FSHL me nr. 3835, datë 16.12.2024, “Për pagesën nga UST të kontributeve të detyrueshme të studentëve që do të zhvillojnë modulën Praktikë pedagogjike të programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor”, në Vendimin e Rektoratit nr. 5 datë 13.01.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.01.2025,

V E N D O S I :

1. Të miratojë pagesën për studentët e Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor”, për kohën e programuar të praktikës profesionale pedagogjike, për kontributin e detyrueshëm për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale gjatë kësaj periudhe.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Administratori, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

